VENDIM
Nr. 61, datë 27.9.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Bashkim Dedjakryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo anëtar i " "
Sokol Berberi anëtar i " "
Vitore Tusha anëtare e " "
Fatmir Hoxha anëtar i " "
Gani Dizdari anëtar i " "
Besnik Imeraj anëtar i " "
Fatos Lulo anëtar i " "
Altina Xhoxhaj Anëtare e " "

me sekretare Edmira Babaj, në datën 21.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 31 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Bledar Bejaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale.

Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-2856, datë 19.11.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 5 dhe 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të Konventës; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në vitin 2007, gjatë një konflikti të ndodhur në një zonë të Athinës në Greqi mes dy grupe shqiptarësh, ka mbetur i vrarë shtetasi G.B. Në lidhje me këtë ngjarje autoritetet greke kanë filluar procedimin penal në ngarkim të shtetasve Bledar Bejaj, M.K., A.Z., D.N., A.N., S.K. dhe Xh.B., të akuzuar për veprat penale "Vrasje me paramendim" të kryer në bashkëpunim dhe "Përleshje", të parashikuara nga dispozitat përkatëse të kodit penal grek. Rezulton gjithashtu se ndaj kërkuesit Bledar Bejaj është lëshuar urdhër arresti i datës 16.10.2007 dhe ai është arrestuar nga autoritetet greke në datën 11.12.2007.

2. Ndërkohë që kishte nisur procedimi penal në Greqi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit të babait të viktimës, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "Vrasje me dashje". Në kuadër të hetimeve të këtij procedimi penal nga ana e organit të akuzës, bazuar në Konventën Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale dhe në nenin 509/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), në datën 23.11.2007, është paraqitur kërkesë për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore greke, duke kërkuar transmetimin e të gjitha akteve procedurale të administruara dhe të përpiluara në lidhje me ngjarjen. Ndaj kësaj kërkese, autoritetet greke kanë kthyer përgjigjen e datës 14.4.2008 se nuk kishte të regjistruar asnjë procedim penal me të dëmtuar shtetasin G.B. Nga ana e Zyrës Qendrore të Interpol-Tirana, pas

komunikimit me zyrën homologe në Greqi, është konfirmuar arrestimi i kërkuesit në lidhje me ngjarjen nga autoritetet greke. Në datën 5.6.2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë u është drejtuar sërish autoriteteve greke me kërkesë për ndihmë juridike, duke kërkuar transmetimin e kopjeve të akteve procedurale të administruara dhe përpiluara prej tyre në lidhje me ngjarjen. Të gjitha këto akte janë paraqitur në gjykim në cilësinë e provës.

3. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 469, datë 16.12.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit Bledar Bejaj për kryerjen e veprës penale "Vrasje me dashje", parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim...".*

4. Me vendimin nr. 206, datë 3.5.2012, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur*: "Lënien në fuqi të vendimit nr. 469, datë 16.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pjesën që ka deklaruar fajtor të pandehurin Bledar Bejaj për veprën penale "Vrasje me dashje", parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, mënyrën e vuajtjes së dënimit dhe shpenzimet gjyqësore. Ndryshimin e vendimit të mësipërm në lidhje me masën e dënimit në këtë mënyrë: Dënimin e të pandehurit Bledar Bejaj me 16 vjet burgim.".*

5. Për arsye se ishte duke vuajtur një masë sigurimi në shtetin grek, kërkuesi nuk ka pasur mundësi të jetë i pranishëm gjatë gjykimit të zhvilluar në gjykatat shqiptare, por është njoftuar nga autoritetet shqiptare dhe ka marrë dijeni për procesin me anë të letërporosisë.

6. Për sa i takon procesit penal të zhvilluar në shtetin grek, rezulton se në përfundim të gjykimit kërkuesi është deklaruar fajtor nga gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 22.10.2010, për kryerjen e veprës penale të përleshjes në formën e sulmit, që u bë nga shumë persona, pasojë e të cilit ishte vdekja e një njeriu dhe është dënuar me 3 vjet burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 5.12.2013, pasi është lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit të Betuar të Evvoias. Pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, bazuar në nenin 450/1/a të KPP-së. Sipas kërkuesit, vendimi i gjykatës greke në themel të tij ka nxjerrë konkluzione të drejta, pasi si prova në këtë gjykim janë marrë edhe thëniet e disa dëshmitarëve të tjerë, që në procesin e zhvilluar në Shqipëri nuk janë administruar si provë qoftë edhe duke lexuar thëniet e tyre.

7. Me vendimin nr. 00–2015–2856, datë 19.11.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

II

8. ***Kërkuesi Bledar Bejaj*** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

8.1 Gjykata e Lartë gabon kur arsyeton se shkak për paraqitjen e kërkesës për rishikim është vetëm rasti i zbulimit të një prove të re, sipas nenit 450/c të KPP-së. Në rastin konkret kërkesa për rishikim nuk është bërë në bazë të kësaj dispozite, por në bazë të nenit 450/a të KPP-së, me arsyetimin se kërkuesi ka marrë pafajësi në shtetin grek (vendim i cili ka marrë formë të prerë më vonë).

8.2 Kolegji Penal ka gabuar kur arsyeton se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 450/c si shkak për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë. Ai gabon kur arsyeton se një vendim penal i mëvonshëm, i cili ka deklaruar fajtor të gjykuarin për një vepër penale më të lehtë, nuk mund të konsiderohet si një ndër rastet e rishikimit. Kërkuesi është akuzuar në shtetin grek për dy vepra penale, vrasje me paramendim dhe përleshje në formën e sulmit. Për veprën penale të vrasjes ai ka marrë pafajësi dhe është dënuar me 3 vjet burgim për veprën penale të përleshjes. Mirëpo ai është dënuar në Shqipëri dhe gjykuar për veprën penale të vrasjes, për të cilën gjykata greke e ka shpallur të pafajshëm.

8.3 Në kohën kur filloi ndjekja penale nga autoritetet shqiptare, kishte nisur një hetim në shtetin grek. Dënimi i kërkuesit është bërë mbi të njëjtat prova dhe autoritetet shqiptare nuk kanë kryer hetime të tjera apo të kenë marrë prova të reja. Kërkuesi është dënuar vetëm mbi të njëjtat fakte, mbi bazën e të cilave ka marrë pafajësi në shtetin grek. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë, duke

mos pranuar kërkesën për rishikim, ka cenuar parimin *ne bis in idem*, të garantuar nga neni 34 i Kushtetutës dhe neni 4 i protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.

8.4. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk plotëson standardin e arsyetimit në përputhje me nenin 142/1 të Kushtetutës. Ai është i paargumentuar, pa referenca ligjore dhe ka kundërthënie dhe paqartësi, pasi Gjykata e Lartë gabimisht i referohet një shkaku ligjor tjetër në rrëzimin e kërkesës për rishikim.

9. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet e tij me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

9.1. Pretendimi për cenimin e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron, pasi kërkuesi është gjykuar nga gjykatat shqiptare përpara se çështja të shqyrtohej në shtetin grek, dhe të kishte një vendim të formës së prerë për të. Fakti i marrjes së një vendimi gjyqësor nga gjykatat greke ndaj kërkuesit, për të njëjtin fakt kriminal për të cilin gjykatat shqiptare kishin kryer një gjykim dhe kishin dhënë një vendim përfundimtar, nuk do të thotë se këto të fundit kanë shkelur këtë parim. Në rastin konkret parimi *ne bis in idem* është shkelur nga gjykata greke (Gjykata e Apelit e Betuar e Evvoias) në kushtet kur kërkuesi ishte gjykuar më parë me një vendim të formës së prerë nga gjykatat shqiptare.

9.2 Gjykata e Lartë me të drejtë ka rrëzuar kërkesën për rishikim, pasi kërkuesi ka dashur të zgjidhë këtë situatë ligjore të dy vendimeve gjyqësore për të njëjtin fakt kriminal me një mjet ligjor të papërshtatshëm sikurse është kërkesa për rishikim. Kjo situatë nuk është parashikuar nga KPP-ja të zgjidhet përmes kërkesës për rishikim, pasi neni 450/a i KPP-së nuk ka pasur parasysh praninë e dy vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj të njëjtit person për të njëjtin fakt kriminal, por rastin kur në një vendim gjyqësor tjetër, të dhënë për një tjetër fakt kriminal, rezultojnë fakte që bien ndesh me faktet e pranuara në vendimin objekt rishikimi. Situata në të cilën ndodhej kërkuesi, në fakt ka lidhje me parashikimet e nenit 474 të KPP-së, në të cilin parashikohet një procedurë e detajuar për disa raste specifike, ku mund të ndodhë që ndaj të njëjtit person, për të njëjtin fakt kriminal, të ekzistojnë njëkohësisht dy vendime penale të formës së prerë.

9.3 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk qëndron, pasi nga vendimi i Gjykatës së Lartë rezulton se ajo ka parashtruar një arsyetim të plotë, duke respektuar plotësisht jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në këtë drejtim. Kolegji ka treguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar qëndrimin e tij në lidhje me mospranimin e kërkesës për rishikim dhe kjo mënyrë arsyetimi koncize nuk mund të cilësohet si mungesë arsyetimi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Përpara se të shprehet për thelbin e pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) vlerëson të ndalet paraprakisht në vlerësimin e legjitimimit të kërkuesit për pretendimet e ngritura në kërkesë.

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Po ashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij në kërkesë *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

12. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka gabuar kur arsyeton se shkak për paraqitjen e kërkesës për rishikim është vetëm rasti i zbulimit të një prove të re, sipas nenit 450/c të KPP-së, pasi në rastin konkret kërkesa për rishikim është bërë në bazë të nenit 450/a të KPP-së. Po ashtu, ai argumenton se është akuzuar në shtetin grek për dy vepra penale, vrasje me paramendim dhe

përleshje në formën e sulmit, ku për veprën penale të vrasjes ka marrë pafajësi, por është dënuar me 3 vjet burgim për veprën penale të përleshjes. Kurse në Shqipëri është gjykuar për veprën penale të vrasjes, për të cilën gjykata greke e ka shpallur të pafajshëm, çka përbën cenim të parimit *ne bis in idem*. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk plotëson as standardin e arsyetimit, në përputhje me nenin 142/1 të Kushtetutës. Ai është i paargumentuar, pa referenca ligjore dhe ka kundërthënie dhe paqartësi, pasi Gjykata e Lartë gabimisht i referohet një shkaku tjetër ligjor në rrëzimin e kërkesës për rishikim.

13. Sipas subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, pretendimi për cenimin e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron, pasi kërkuesi është gjykuar nga gjykatat shqiptare përpara se çështja të shqyrtohej në shtetin grek, dhe të kishte një vendim të formës së prerë për të. Po ashtu, nga vendimi i Gjykatës së Lartë rezulton se ajo ka parashtruar një arsyetim të plotë, duke treguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar qëndrimin në lidhje me mospranimin e kërkesës për rishikim dhe kjo mënyrë arsyetimi koncize nuk mund të cilësohet si mungesë arsyetimi.

14. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke iu referuar dyshimit për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesit, Gjykata ka theksuar se është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin nga ana e saj të pretendimeve të ngritura (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimin nr. 27 datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta e aksesit kërkon edhe pajisjen e palëve në proces me një vendim gjyqësor të arsyetuar, në të cilin gjykata tregon me qartësi faktet, ligjin e zbatueshëm dhe arsyet që e kanë shtyrë për të bërë zgjedhjen ndërmjet disa mundësive. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke iu dhënë njëkohësisht mundësinë për ta kundërshtuar atë. Duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 5, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka theksuar se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Kërkesa për rishikim ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk kishin ndodhur ose nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt

një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e këtij mjeti të veçantë ankimi, Gjykata vëren se mospranimi i kërkesës për rishikim i heq përfundimisht palës mundësinë për rihapjen e procesit gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme që dhoma e këshillimit të japë një vendim të arsyetuar për shkaqet që e kanë çuar atë në marrjen e një vendimi të tillë. Kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga përmbajtja e dispozitave procedurale penale për rishikimin (nenet 450 dhe 453 të KPP-së), rezulton se kërkesa për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Ky kolegj verifikon fillimisht rastet e rishikimit, legjitimitetin e kërkuesit, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe praninë e kritereve ligjore për shqyrtimin e saj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim (*shih vendimin nr. 19, datë 1.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket shqyrtimit paraprak mbi vetë rëndësinë e provës së re, Gjykata ka theksuar se ky gjykim është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon kjo Gjykatë (*shih vendimin nr. 7, datë 7.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve penale të formës së prerë, në bazë të nenit 450/a të KPP-së, duke pretenduar se vendimi i gjykatës greke, i cili ka marrë formë të prerë, në themel të tij ka nxjerrë konkluzione të drejta edhe për arsye se në atë gjykim janë marrë edhe thëniet e disa dëshmitarëve të tjerë, të cilat në gjykatat shqiptare nuk janë administruar si prova, qoftë edhe duke u lexuar gjatë procesit. Kolegji Penal në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin me arsyetimin se ajo është bërë jashtë rasteve të parashikuara nga neni 450 i KPP-së për kundërshtimin e një vendimi penal të formës së prerë. Pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në kërkesë, Kolegji Penal ka arsyetuar se *"në referim të dispozitave ligjore të KPP-së, një vendim penal i mëvonshëm, siç është vendimi penal i Gjykatës së Apelit të Betuar të Evvoias, i hedhur në regjistër me nr. 09/2014, në datën 24.1.2014, Greqi, me anë të të cilit i gjykuari Bledar Bejaj është deklaruar fajtor dhe dënuar me 3 vjet burg për aktin e përleshjes në formën e sulmit, nuk mund të konsiderohet provë në kuptim të nenit 149 të këtij Kodi... Siç konkludohet qartë edhe nga përmbajtja e nenit 450 të KPP-së, një vendim penal i mëvonshëm, i cili ka deklaruar fajtor të gjykuarin për një vepër penale më të lehtë, për të cilin ekziston një vendim fajësie po për të njëjtën vepër penale, nuk mund të konsiderohet si një nga rastet e rishikimit të vendimit penal të formës së prerë."*

19. Duke i vlerësuar pretendimet e kërkuesit në këndvështrim të respektimit të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, i cili ka analizuar pretendimet e tij dhe është shprehur për thelbin e tyre, duke u dhënë atyre një përgjigje përfun-dimtare, të arsyetuar. Për rrjedhojë, kërkuesi e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë si nga pikëpamja formale, duke përdorur kërkesën për rishikim si mjetin procedural ankimues, ashtu edhe në aspektin substancial, duke marrë përgjigje edhe për thelbin e pretendimeve të paraqitura.

20. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.
Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

MENDIM PAKICE

1. Jam i mendimit se kërkesa e shtetasit Bledar Bejaj për shfuqizimin e vendimit nr. 00–2015–2856, datë 19.11.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është e drejtë dhe si e tillë duhej pranuar për arsyet e mëposhtme.

2. Nga rrethanat e çështjes, sikurse konstaton edhe shumica, rezulton se kërkuesi, për të njëjtin konflikt që ka ndodhur në Athinë (Greqi), është gjykuar si në shtetin shqiptar, ashtu edhe në atë grek. Konkretisht, kërkuesi është deklaruar fajtor për veprën penale të vrasjes me dashje nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe është dënuar me 16 vjet burgim, ndërsa me vendimin e Gjykatës së Apelit të Betuar të Evvoias të Republikës së Greqisë është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të përleshjes në formën e sulmit nga shumë persona, me pasojë vdekjen e shtetasit G.B. dhe është dënuar me 3 vjet burgim, ndërkohë që për veprën penale të vrasjes ai ka marrë pafajësi nga gjykata greke.

3. Pas marrjes formë të prerë të vendimit të gjykatës greke, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, bazuar në nenin 450/1/a të KPP-së, sipas të cilit rishikimi i një vendimi të formës së prerë mund të kërkohet, ndër të tjera, kur faktet e dhëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë. Me vendimin nr. 00–2015–2856, datë 19.11.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

4. Në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, parimin *ne bis in idem* dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

5. Shumica ka vlerësuar se kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, i cili ka analizuar pretendimet e tij dhe është shprehur për thelbin e tyre, duke u dhënë atyre një përgjigje përfundimtare, të arsyetuar. Për rrjedhojë, kërkuesi e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë si nga pikëpamja formale, duke përdorur kërkesën për rishikim si mjetin procedural ankimues, ashtu edhe në aspektin substancial, duke marrë përgjigje edhe për thelbin e pretendimeve të paraqitura (shih paragrafin nr. 19 të vendimit të shumicës).

6. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret një trajtim i tillë i ngushtë formalo-juridik i kërkesës, lë jashtë vëmendjes disa nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, respektimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, si dhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

7. Sikurse konstaton edhe shumica, në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të

drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 45, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Lidhur me kërkesën për rishikim, sikurse thekson dhe shumica (*shih paragrafin nr. 16 të vendimit të shumicës*), sipas jurisprudencës së Gjykatës, ajo përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e këtij mjeti të veçantë ankimi, Gjykata ka vërejtur se mospranimi i kërkesës për rishikim i heq përfundimisht palës mundësinë për rihapjen e procesit gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme që dhoma e këshillimit të japë një vendim të arsyetuar për shkaqet që e kanë çuar atë në marrjen e një vendimi të tillë (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin në shqyrtim, rezulton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve penale të formës së prerë, në bazë të nenit 450/a të KPP-së, duke pretenduar se vendimi i gjykatës greke, i cili ka marrë formë të prerë, në raport me vendimet e gjykatave shqiptare, në themel të tij ka nxjerrë konkluzione më të drejta dhe të sakta jo vetëm për faktin se krimi është kryer në territorin grek, por edhe për arsye se në atë gjykim janë thirrur disa dëshmitarë të tjerë okularë, deklarimet e të cilëve nuk janë administruar si prova nga gjykatat shqiptare, qoftë edhe duke u lexuar thëniet e tyre.

11. Pavarësisht këtyre pretendimeve, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke anashkaluar në mënyrë të paarsyeshme vlerësimin e bazës ligjore mbi të cilën mbështetet kërkuesi, e ka trajtuar kërkesën e paraqitur në këndvështrim të respektimit të kërkesave të nenit 450/c të KPP-së, duke arsyetuar jashtë kontekstit të çështjes dhe në mënyrë të gabuar, se në rastin konkret një vendim penal i mëvonshëm, siç është vendimi penal i gjykatës greke, nuk mund të konsiderohet provë e re në kuptim të nenit 149 të këtij Kodi?!

12. Gjykata ka vlerësuar se, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Ndërsa gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Gjykata investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë, pasi një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimin nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga sa më lart, përderisa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim, duke pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, mbështetur edhe në parimin kushtetues *ne bis in idem*, për shkak të dënimit të tij në dy shtete me vendime gjyqësore të formës së prerë për të njëjtin fakt penal, mendoj se ishte detyrë e kësaj gjykatë të vlerësonte bazueshmërinë e këtij pretendimi dhe t'i jepte përgjigje të arsyetuar në lidhje me të, pra nëse në rastin konkret plotësoheshin kërkesat e shkronjës "a" të nenit 450 të KPP-së. Përkundrazi, Gjykata e Lartë, edhe pse si shkak të kërkesës për rishikim i referohet një vendimi penal të formës së prerë (i parashikuar në nenin 450/a të KPP-së), në dhomë këshillimi, duke u bazuar te neni 450/c i KPP-së, nëpërmjet një vendimi kontradiktor, ka vendosur mospranimin e kërkesës si të pabazuar

në ligjin procedural penal (*shih f. 3 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kësaj të mete nuk ka mundur t'i shmanget as shumica në arsyetimin e vendimit të saj.

14. Nga ana tjetër, jam i mendimit se Kolegji Penal në dhomë këshillimi, nëpërmjet arsyetimit të lartpërmendur ka dalë jashtë funksionit të tij ligjor, pasi duke u shprehur për themelin e kërkesës, ka marrë kompetencat e seancës gjyqësore. Sipas nenit 453/2, të KPP-së, Kolegji Penal në dhomë këshillimi vendos mospranimin e kërkesës për rishikim, kur kjo e fundit është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 450 të KPP-së, kur është bërë nga ata që nuk kanë këtë të drejtë ose kur rezulton haptazi e pambështetur. Ndërsa në rastin konkret ka ndodhur e kundërta, dhoma e këshillimit është ndalur në shqyrtimin nëse ndodhej përpara kushteve të parashikuara nga neni 450/a apo 450/c i KPP-së. Ky shqyrtim sipas parashikimeve të KPP-së i takon seancës gjyqësore dhe jo fazës seleksionuese të dhomës së këshillimit. Në këtë mënyrë çmoj se Gjykata e Lartë ka cenuar edhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

15. Si përfundim, vlerësoj se në rastin konkret Gjykata e Lartë, duke mos pranuar kërkesën për rishikim të kërkuesit, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë dhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

Anëtar: Vladimir Kristo